

Njoftim për Shtyp datë 09.01.2026

Datë: 09.01.2026



Sot, më datë 09.01.2026, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi Mbledhjen Plenare të radhës, në të cilën shqyrtoi çështjet si më poshtë:

Këshilli zhvilloi seancën dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. [...], me funksion gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm [...], dhe në përfundim vendosi shtyrjen e seancës për në datën 29.01.2026, ora 10:00.

Këshilli miratoi vendimin për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. Alma Kodraliu.

Më tej, Këshilli vendosi për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 830, nr. 831, datë 04.12.2025 dhe nr. 836, datë 09.12.2025.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, Këshilli miratoi raportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës znj.[...], me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016.

Këshilli vendosi për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë të shpallura me vendimet nr. 830 dhe nr. 831, datë 04.12.2025 dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të shpallur me vendimin nr. 836, datë 09.12.2025 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe pas hedhjes së shortit caktoi relatorin për secilin kandidat.

Në përfundim, Këshilli vendosi për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative, për shkak të përfundimit të mandatit të z. Asim Vokshi.